

## Aktivitetet e Qendrës Kulturore për Diasporë dhe Mërgatë - Zurich

Nëntor, 2014

03.11.2014

Ne QKKDM- Takim me shkrimtarin dhe publicistin Murat Avdiu dhe kolegun e tij Mehmet Bislimi. Ata i falën 4 veprat e tija te botuara per bibliotekën e QKKDM-Zvicër



05.11.2014

Pjesëmarrje në takimin e përvjetshëm të Unionit të grave Zvicërane të cilat merren me aktivitete të ndryshme dhe me ruajtjen e kulturës dhe identitetit të popullit.

06.11 2014

Takim me kryetarët e 15 shoqatave pjesëmarrëse në tubimin e 28 nëntorit ne Amrisvill. Janë bërë të gjitha parapërgatitjet për kremtimin e festës së 28 nëntorit.

15.11.2014

Me shtimin e vazhdueshëm të klubeve shqiptare të futbollit në Zvicër - aktualisht ka 23 sosh - lindi edhe nevoja për themelimin e Unionit të Klubeve Shqiptare të Futbollit në Zvicër.

Sipas këshillit iniciues, objektivi kryesor i këtij Unioni do të jetë bashkëpunimi i ndërsjellë mes klubeve shqiptare në Zvicër si dhe bashkëpunimi me autoritetet e futbollit në vend dhe vendlindje .

Në kuvendin e mbajtur në Bernë, morrën pjesë edhe përfaqësuesit e ambasadave, të Qendrës së Kulturës së Kosovës si dhe përfaqësuesi i FFSH-së.

Në mesin e të pranishmëve ishin edhe pjesëtarë të korit diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë si dhe, me pjesëmarrje nderuan edhe edhe përfaqësues nga Unioni i Klubeve Shqiptare të Futbollit në Gjermanisë



**16.11.2014**

Pjesëmarrje ne tubimin e shoqatës Valët e Liqenit nga Ladorishti në Zyrih. Ky tubim iu kushtua festave të nëntorit dhe ditës se masakrimit të 82 martirëve të këtij fshati nga forcat naziste në Luftën e Dytë Botërore.



**21.11.2014**

„Swikos“ është festivali shqiptaro-zviceran i filmit të shkurtër, i cili për të tetën herë me rradhë mbledhi në Bazel të Zvicrës regjisorë, skenaristë dhe producentë filmash nga Kosova, Zvicra, Gjermania, Austria.

Për dy ditë rresht, u prezantuan 14 projekte filmike, pesë prej të cilave janë të regjisorëve kosovarë, 6 janë të atyre zviceranë, 2 prej tyre nga Gjermania dhe Austria dhe 1 nga Maqedonia.

Në konkurrencë ishin 7 prodhime të artistëve zviceranë dhe 7 prodhime ndërkombëtare. Filmat më të mirë u shpërblyen në pesë kategori dhe me një çmim të publikut. Edicionin e sivjetmë të festivalit e ka sponsorizuar Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës dhe ajo e Kulturës.



**22.11.2014**

Me manifestimin qëndror në Salle des Fêtes des Avanchets në Gjenevë, organizuar nga Qendra Kulturore për Diasporë dhe Mërgatë në Zvicër, u mbajt solemniteti me rastin e Ditës së Flamurit, ku performuan, fëmijë të mësimit plotësues në gjuhën shqipe, artistë e këngëtarë të ndryshëm, ndërsa mysafirë kishte edhe nga autoritetet locale zvicërene, si dhe nga Ministria e Diasporës dhe ajo e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.



**28.11.2014**

Për nder të festës së 28 Nëntorit, në Qendrën Kulturore të Kosovës në Zürich, u mbajt një ekspozitë e artistëve të diasporës shqiptare si dhe orë letrare ku u lexuan poezi e punime nga poetë dhe shkrimtarë shqiptarë nga Gjermania, Zvicra e Suedia. Të pranishmit i përshëndetën ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së kësaj qendre, Shukrie Ramadani si dhe konzulli i Kosovës në Cyrih, dr. Salih Sefa.

Në këtë ekspozitë me punimet e tyre kanë marrë pjesë Adem Dermaku, Arsim Berisha, Agron Bajrami, Afrim Hajdari, Bashkim Beqiri, Blerta Abazi, Besim Morina, Gani Bytyqi, Zogëza Dauti që janë edhe anëtarë të shoqatës së Artistëve Figurativë për Zvicër Janë ekspozuar edhe punime të heroit të Kosovës, piktorit dhe poetit, Agim Ramadani.

Piktorja e vogël e ardhur nga Gjermania, Abetare Berrila kishte punuar një punim të veçantë për t'ia dhuruar Qendrës Kulturore në Zvicër.



29.11.2014

Manifestimi qëndror për nder të festave të 28, u mbajt në qytezën e Amrisville, në prani të mijëra bashkatdhetarëve që kishin udhëtuar nga shumë qytete të Zvicrës për të shijuar pjesë të folklorit dhe tingujve të muzikës shqiptare. Rreth 18 shoqëri kulturore artistike, të organizuara nga Këshilli Drejtues për organizimin e festave të Nëntorit, përbërë nga më se 20 shoqata shqiptare në Zvicër, drejtuar nga u.d. drejtoresha e Qendrës Kulturore, Shukrije Ramadani, paraqitën program skenik për rreth tri orë.

Të pranishmit i ka përshndetur edhe Ministri i Diasporës, z. Ibrahim Makolli, duke ngritur lart kontributin e diasporës në të gjitha zhvillimet në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare ndërsa ka shprehur nderimin për të gjithë ata që me sakrificën dhe punën e tyre kanë punuar për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ai ka thënë se e gëzon prania e madhe të publikut dhe sidomos të të rinjve. Kjo është një garanci se kultura dhe tradita shqiptare do të jetojnë edhe më tej.





30.11.2014

Krijimi i rrjetit të të rinjëve, studenteve dhe asociacioneve të ndryshme në Zvicër

Me iniciativën e Ministrisë së Diasporës, në vazhden e përpjekjeve të organizimit sa më të mirë të shoqatave dhe individëve në diasporë, është krijuar edhe rrjeti i të rinjëve dhe studentëve në Zvicër.

Në prani të më se 50 përfaqësuesve të shoqatave, klubeve të ndryshme, individë dhe aktivistë, si dhe të ftuar nga rrjeti tashmë i krijuar në Austri, u përzgjedhën gjashtë përfaqësues nga Universitete dhe kantone të ndryshme, të cilët do të bartin barrën e funksionalizimit të rrjetit, si trup koordinues.

Takimi u mbajt në lokalet e Konsullatës së Kosovës në Cyrih, ndërsa u organizua me ndihmën e Qendrës Kulturore për Diasporë dhe Mërgatë në Zvicër.

Në diskutim u shtruan shumë çështje rreth qëllimit, formës dhe objektivave të rrjetëzimit rinor dhe veçanërisht atij studentor. Një prej qëllimeve të rrjeteve ishte edhe krijimi i një databaze me të dhëna për profilin e anëtarëve të rrjeteve që do t'i koordinojnë aktivitetet e tyre.

